



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“VETERINARI”**

**Niveli IV në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit IV të KEK<sup>2</sup>**

**N-IV-21**

**Tiranë, 2021**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

---

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë, Web site [www.akafp.gov.al](http://www.akafp.gov.al)

Tel/fax.+355 42237087

<b>Emërtimi i kualifikimit</b>	<b>“Veterinari”</b>			<b>Kodi N-IV-21</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>3800-4200 orë</b>	<b>Niveli</b>	<b>IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK</b>	
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi i kualifikimit profesional <b>“Veterinari”</b> niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim të teknikut të mesëm për blegtorinë, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin mësimor <b>“Veterinari”</b> kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;</li> <li>– të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional <b>“Veterinari”</b>, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit, të teknikut të mesëm në këtë fushë, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si teknik i mesëm në ndërmarrje/ferma të ndryshme bujqësore, e blegtorale, teknik ndërzimi, teknik në baxho, prerës thundrash, teknik në klinikë veterinare të kafshëve të shoqërimit, teknik në thertore, ndihmës në farmacitë veterinare ose veprimtari të tjera në fushën e blegtorisë. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në fushën e prodhimeve blegtorale.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së <b>“Maturës Shtetërore Profesionale”</b>, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm ose universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>N-III-11, N-IV-17</b>			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

**Rezultatet e të nxënit në:**

## **NJOHURI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Veterinari” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të shpjegojë organizimin dhe funksionet e Shërbimit Veterinar në vend;
- Të përshkruajë kuadrin rregullator në fushën e Shërbimit Veterinar;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe përdorimin e mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve në shërbimin veterinar;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të një preventivi për një shërbim të dhënë;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të hapave dhe afateve të realizimit të një shërbimi;
- Të listojë llojet e dokumentacionit teknik në fushën e Shërbimit Veterinar;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të shpjegojë mënyrat e pastrimit dhe mirëmbajtjes të mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;

### **Mikroorganizmat dhe infeksioni**

- Të klasifikojë grupet kryesore të mikrobeve sipas formës, madhësisë, ndërtimit dhe sipas natyrës së tyre;
- Të përshkruajë jetën e mikroorganizmave;
- Të shpjegojë konceptin e infeksionit;
- Të përshkruajë llojet kryesore të infeksioneve;
- Të shpjegojë prejardhjen e infeksionit;
- Të përkufizojë konceptin e sëmundjes infektive;
- Të përshkruajë zhvillimin e sëmundjes infektive;
- Të listojë rrugët e hyrjes së mikrobeve në organizëm;
- Të përshkruajë format e shfaqjes së sëmundjeve infektive;
- Të listojë mjetet kryesore të laboratorit veterinar;
- Të listojë reagentët më të përdorshëm të një laboratorit bazë dhe fushor;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse dhe përdorimin e mikroskopit;
- Të përshkruajë burimet parësore dhe dytësore të përhapjes së infeksionit;
- Të listojë rrugët e eliminimit të mikrobeve nga organizmi;
- Të përshkruajë barrierat mbrojtëse të organizmit ndaj mikroorganizmave patogjenë;
- Të përshkruajë imunitetin dhe llojet e tij;
- Të përshkruajë alergjinë dhe anafilaksinë;
- Të listojë antigenët dhe antitruapat specifik;

- Të shpjegojë përdorimin e alergjenëve dhe të biopreparateve për diagnostikimin e sëmundjeve infektive;

### **Profilaksia veterinare**

- Të shpjegojë konceptin e profilaksisë për sëmundjet infektive;
- Të përshkruajë profilaksinë e përgjithshme dhe të veçantë për parandalimin e sëmundjeve infektive;
- Të listojë masat e profilaksisë së përgjithshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e dezinfektimit për kafshët dhe punonjësit në parandalimin e transmetimit të sëmundjeve infektive;
- Të përshkruajë llojet dhe format e dezinfektimit;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e dezinfektimit dhe deratizimit;
- Të listojë llojet e dezinfektantëve dhe përdorimet e tyre në veterinarë;
- Të argumentojë faktorët përcaktues të shkallës së veprimit të dezinfektantëve;
- Të argumentojë zbatimin e profilaksisë së veçantë;
- Të përshkruajë konceptin e karantinës veterinare dhe rregullat bazë të saj në përputhje me ligjin veterinar;
- Të përshkruajë konceptin e izolimit të kafshëve me sëmundje infektive dhe izolatorit, parimet themelore të funksionimit;
- Të përshkruajë mënyrat e asgjësimit të kafshëve të ngordhura, materialeve dhe mbeturinave me djegie;
- Të shpjegojë rëndësinë e personelit përkatës, masave parandaluese dhe kushtet për kafshët e sëmura;
- Të listojë mënyrat e asgjësimit të kafshëve të ngordhura, të plehut, mbetjeve dhe materialeve mjekësore tjera të infektuara, etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e masave veterinare për mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike;

### **Sëmundjet infektive**

- Të përshkruajë veçoritë e shkaktarëve të sëmundjeve infektive;
- Të rendisë burimet e infeksionit si dhe faktorët predispozues për sëmundjet kryesore infektive;
- Të përshkruajë shenjat klinike të sëmundjeve infektive në kafshë;
- Të përshkruajë ndryshimet makroskopike për sëmundjet kryesore infektive;
- Të përshkruajë mjekimin dhe skemat përkatëse në kafshë me sëmundje kryesore infektive;
- Të përshkruajë planin profilaktik për sëmundjet infektive në kafshë;
- Të përshkruajë planin e zbatimit të kalendarit vjetor të vaksinimeve në kafshë;
- Të shpjegojë rëndësinë e gjurmimit për sëmundjet infektive dhe zbatimin e hapave përkatëse;
- Të përshkruajë dokumentacionin veterinar për sëmundjet infektive në kafshë të ndryshme;
- Të përshkruajë elementët e biosigurisë në fermë dhe rëndësinë e tyre për kontrollin e sëmundjeve infektive;
- Të shpjegojë filozofinë “Një botë, një shëndet”;

### **Parazitët dhe sëmundjet parazitare**

- Të përshkruajë rëndësinë dhe objektin e Parazitologjisë veterinare;
- Të përshkruajë lidhjet parazit-përbujtës;
- Të përshkruajë morfologjinë dhe zhvillimin biologjik të parazitëve, shkaktarë të sëmundjes;
- Të rendisë rrugët e infestimit të kafshëve nga parazitët;
- Të përshkruajë metodat e diagnostikimit të sëmundjeve parazitare në kafshët e gjalla dhe të ngordhura;
- Të shpjegojë rëndësinë e dehelmentizimit për parandalimin e sëmundjeve parazitare në kafshë;
- Të përkufizojë sëmundjet parazitare të kafshëve dhe shpendëve të shkaktuara nga tremadodë, cestodë, nematode etj.;
- Të shpjegojë shkallën e infestimit në kategori të ndryshme kafshësh
- Të përshkruajë shenjat kryesore klinike të sëmundjeve parazitare në kafshë dhe shpendë;
- Të përshkruajë ndryshimet makroskopike të organeve të infestuara;
- Të përshkruajë mjekimin e kafshëve me sëmundjet kryesore parazitare;
- Të rendisë masat për parandalimin e sëmundjeve kryesore parazitare;
- Të përshkruajë sëmundjet parazitare të kafshëve dhe shpendëve të shkaktuara nga artropodët, araknidet, protozoarët etj.;

### **Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve**

- Të përshkruajë rëndësinë e higjienës së mjedisit brenda dhe jashtë stallës;
- Të përshkruajë rolin dhe nevojat për ujë në organizëm;
- Të përshkruajë kushtet higjienike të ujit, të enëve të tij, baseneve, ujë pirëseve, si dhe procedurat e pastrimit të tyre;
- Të shpjegojë procedurat e higjienizimit të impianteve mjelës, të impianteve të ushqimit dhe ujit në kafshë dhe shpendë;
- Të listojë llojet e detergjenteve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të mbetjeve në enët, makinat mjelëse apo sipërfaqe të tjera, si dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë kushtet higjienike të ushqimeve me prejardhje bimore dhe shtazore gjatë ruajtjes, përpunimit dhe përdorimit të tyre;
- Të rendisë shërbimet e higjienës në trupin e kafshës (lëkurës, thundrave, gjirit, etj.);
- Të përshkruajë rëndësinë e procesit të qethjes në dhen lidhur me higjienën dhe mirëqenien e kafshëve;
- Të përshkruajë kushtet higjienike të vendqëndrimeve, vendpushimeve dhe ambienteve të tjera ku qëndrojnë dhe lëvizin kafshët;
- Të përshkruajë kushtet higjienike për kafshët para, gjatë dhe pas pjelljes;
- Të rendisë masat higjienike gjatë mjeljes, ruajtjes, transportit dhe përpunimit të qumështit;
- Të rendisë kushtet për ndërtimin e komplekseve blegtorale për kategori të ndryshme të kafshëve bujqësore;
- Të përshkruajë llojet e dezinfektimit mekanik, fizik, kimik në trupin e kafshëve, mjediseve dhe objekteve të ndryshme;

### **Mjedisi dhe marrëdhënia reciproke kafshë-mjedisi**

- Të përshkruajë parimet bazë për mjedisin dhe ndikimin e tij në kafshë;
- Të shpjegojë rolin e oksigjenit në qeniet e gjalla dhe ndikimin e gazeve të dëmshme në organizëm;
- Të përshkruajë rolin e rrezatimit diellor në shëndetin dhe prodhimtarinë e kafshëve;
- Të shpjegojë ndikimin e aklimatizimit në zhvillimin e kafshëve;
- Të shpjegojë ndikimin e kafshëve në mjedis;
- Të shpjegojë mirëqenien e kafshëve si koncept dhe rëndësinë e saj;
- Të listojë pesë liritë themelore të kafshëve;

### **Kujdesi për shëndetin e kafshëve**

#### ***Anatomia dhe fiziologjia e kafshëve***

- Të shpjegojë thelbin e teorisë qelizore dhe funksionet e organeleve dhe membranës qelizore.
- Të përshkruajë rajonet kryesore anatomike të trupit dhe nomenklaturën bazë anatomike;
- Të përshkruajë sistemin skeletor, ndërtimin dhe funksionet e tij;
- Të përshkruajë sistemin muskolor, llojet, tiparet dhe funksionet e muskujve të skeletit, atyre të lëmuar dhe muskullit të zemrës;
- Të përshkruajë mekanizmin e tkurrjes muskulore dhe të përcjelljes së nxitjes në nerva;
- Të përshkruajë sistemin e tretjes, organet kryesore dhe funksionet e tyre;
- Të përshkruajë tretjen në gojë, stomak e zorrë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionet e parastomakëve;
- Të shpjegojë procesin e përthithjes në aparatit e tretjes;
- Të përshkruajë sistemin nervor qendror dhe atë periferik, ndërtimin dhe funksionet themelore të tyre;
- Të shpjegojë reflekset e thjeshta në kafshë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionet kryesore të organeve të qarkullimit të gjakut;
- Të shpjegojë funksionet e gjakut;
- Të krahasojë qarkullimin e madh dhe të vogël të gjakut;
- Të përshkruajë sistemin limfatik dhe funksionet kryesore të tij;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik dhe funksionet kryesore të organeve të frymëmarrjes;
- Të përshkruajë fazat e frymëmarrjes;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik dhe fiziologjinë e organeve të sistemit urinar;
- Të përshkruajë gjëndrat me sekrecion të brendshëm dhe funksionet e hormoneve që ato prodhojnë;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik të organeve gjinore dhe funksionet kryesore të tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik të organeve të shqisave dhe funksionet e tyre;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik dhe funksionet e lëkurës;
- Të shpjegojë formimin, rritjen dhe ndërtimin e qimes;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik të thundrës;
- Të përshkruajë treguesit klinikë normale në kafshë;
- Të listojë treguesit normalë jetësorë të kafshëve;
- Të përshkruajë sjelljen (etologjia) e kafshëve në situata të veçanta;

#### ***Patologjitë në kafshë***

- Të përshkruajë sëmundjen si proces;
- Të rendisë shkaqet e sëmundjeve në kafshë;
- Të përshkruajë proceset regresive dhe progresive në organizëm, shkaqet dhe shenjat e tyre në kafshë;
- Të përshkruajë tumoret, shkaqet dhe klasifikimin e tyre;
- Të përshkruajë inflamacion, shenjat dhe llojet e tij;
- Të përshkruajë patologjitë kryesore të sistemit kardiovaskular;
- Të përshkruajë patologjitë kryesore të aparatit të tretjes;
- Të përshkruajë patologjitë më të shpeshta të sistemit nervor;
- Të përshkruajë patologjitë kryesore të aparatit uro-gjinor etj.;
- Të përshkruajë mënyrën, vendin dhe rregullat e kryerjes së nekropsisë në kafshë;

### ***Sëmundjet e brendshme***

- Të përshkruajë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve të aparatit tretës;
- Të përshkruajë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve aparatit të frymëmarrjes;
- Të përshkruajë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve të sistemit kardiovaskular;
- Të përshkruajë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve të sistemit nervor;
- Të përshkruajë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve të aparatit urogjinor;
- Të përshkruajë parimet kryesore të mjekimit në kafshë me sëmundje sipas sistemeve dhe aparateve të organizmit;
- Të rendisë shkaqet e sëmundjeve metabolike, hipo dhe hipervitaminozave, mjekimin dhe masat profilaktike për parandalimin e tyre;
- Të përshkruajë shenjat e përgjithshme dhe mjekimin e kafshëve të helmuara nga lëndë kimike;
- Të listojë bimët helmuese dhe efekti i tyre në organizmin e kafshës;
- Të përshkruajë shenjat klinike në kafshë të helmuara nga duhani, sorgumi, patatja, panxhari, etj.;
- Të përshkruajë mjekimin dhe masat profilaktike për parandalimin e helmimeve në kafshë;
- Të përshkruajë sëmundjet e kafshëve të reja, shenjat klinike, mjekimin dhe masat për parandalimin të tyre;
- Të përshkruajë sëmundjet e kafshëve e shoqërimit, shenjat klinike, mjekimin dhe masat për parandalimin të tyre;
- Të përshkruajë sëmundjet e lëkurës, muskujve, artikulacioneve dhe të tendinave;
- Të përshkruajë sëmundjet e rajonit të kokës, zverkut, vitheve, barkut, organeve gjinore, të syrit dhe të gjymtyrëve që hasen më shumë në praktiken veterinare;
- Të përshkruajë sëmundjet në shpendë, shenjat klinike, mjekimin dhe masat për parandalimin të tyre;

### **Metodat diagnostikuese**

- Të rendisë metodat e vlerësimit të kafshës së sëmurë;
- Të përshkruajë marrjen e anamnezës;
- Të përshkruajë habitusin në kafshë;
- Të përshkruajë kontrollin e aparatit tretës;
- Të përshkruajë kontrollin e aparatit të frymëmarrjes;

- Të përshkruajë kontrollin e aparatit kardiovaskular dhe sistemit nervor qendror
- Të listojë tipet e frymëmarrjes;
- Të krahasojë frymëmarrjen patologjike me atë fiziologjike;
- Të përshkruajë metodat e kontrollit të aparatit urinar;
- Të theksojë rëndësinë e kontrollit të urinës në përcaktimin e gjendjes së organizmit;
- Të listojë çrregullimet e sjelljes në kafshë;

### **Kujdesi për shëndetin riprodhues**

#### ***Riprodhimi i kafshëve bujqësore***

- Të shpjegojë anatominë dhe fiziologjinë e gjirit dhe aparatit të riprodhimit në kafshë;
- Të shpjegojë mënyrat e shumëzimit në shpendë dhe çeljen e zogjve në inkubator;
- Të shpjegojë rritjen dhe shumimin e krimbit të mëndafshit dhe bletës;
- Të shpjegojë konceptin e pjekurisë seksuale dhe asaj trupore;
- Të shpjegojë ciklin seksual, periudhat dhe karakteristikat e tij në kafshët;
- Të listojë format e trupit të verdhë;
- Të shpjegojë hormonet dhe rolin e tyre në rregullimin e ciklit seksual;
- Të shpjegojë sinkronizimin e afshit;
- Të shpjegojë ndërzimin dhe rëndësinë e njohjes së refleksive seksuale;
- Të shpjegojë procesin e fekondimit;
- Të shpjegojë periudhat e zhvillimit embrional dhe fetal dhe funksionet e placentës në kafshë;
- Të shpjegojë ndryshimet anatomike, fiziologjike dhe periudhën e mbarsmërisë në kafshë;
- Të përshkruajë pozicionin e fetusit në muaj të ndryshëm të mbarsmërisë kafshë;
- Të përshkruajë shenjat paralajmëruese, procesin e pjelljes dhe fazat e tij;
- Të shpjegojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes;
- Të shpjegojë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe të porsalindurve;

#### ***Patologjitë e organeve të riprodhimit***

- Të listojë shenjat e dhimbjeve të parakohshme, në kafshët barsë dhe shkaqet e tyre;
- Të listojë llojet e dështimeve në kafshët dhe shkaqet e tyre;
- Të shpjegojë shenjat klinike dhe metodat e ndërhyrjes pa gjak në pjelljet e vështira në kafshë;
- Të rendisë mjetet dhe instrumentet në pjelljet e vështira;
- Të shpjegojë shkaqet, shenjat dhe mjekimin për mbetjet të shtratit në specie të ndryshme të kafshëve;
- Të shpjegojë shkaqet, shenjat dhe mjekimin për prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme;
- Të listojë shkaqet, shenjat klinike, mjekimin dhe masat parandaluese në patologjitë e organeve gjinore;
- Të identifikojë shkaqet e shterpësisë të përkohshme dhe të përhershme në kafshë;
- Të përkufizojë mastitet në kafshë;
- Të përshkruajë shkaqet, shenjat klinike, mjekimin dhe masat parandaluese të mastiteve në kafshë;



- Të klasifikojë llojet e mastiteve sipas kohëzgjatjes dhe karakterit të inflamacionit;
- Të krahasojë mastitet klinike me mastitet subklinike (të fshehta) në lopë;
- Të përshkruajë shenjat klinike të plagëve të gjirit;
- Të listojë shkaqet, shenjat klinike, mënyrat e trajtimit dhe masat për parandalimin e asfiksionit, ftohjes trupore dhe hipoglicemisë në kafshët e porsalindura;

### **Përmirësimi racor në kafshë**

- Të shpjegojë rëndësinë e përmirësimit racor në gjedh, të imta, derra, shpendë etj.;
- Të shpjegojë në mënyrë skematike përmirësimin racor dhe kryqëzimet në kafshë;
- Të klasifikojë racat kryesore të kafshëve sipas drejtimit ekonomik;
- Të listojë treguesit racore të certifikatës gjenealogjike;
- Të shpjegojë treguesit kryesorë të certifikatës gjenealogjike;
- Të shpjegojë përlllogaritjen e pjellorisë në lopë;

### **Inseminimi i kafshëve bujqësore**

- Të shpjegojë përparësitë e inseminimit artificial (IA) kundrejt atij natyral;
- Të shpjegojë planifikimin e ciklit riprodhues të kafshës dhe përgatitjen e kalendarit të tij;
- Të rendisë detyrat e teknikut të inseminimit artificial;
- Të shpjegojë kohën më të përshtatshme të inseminimit për herë të parë në kafshë;
- Të rendisë tiparet racore të damazëve që përzgjidhen për çiftëzim;
- Të listojë instrumentet e inseminimit artificial sipas llojit të kafshëve;
- Të vlerësojë spermën nga ana vizuale dhe mikroskopike;
- Të rendisë rregullat e marrjes, transportimit, ruajtjes dhe vlerësimit të spermës për inseminimin artificial në lopë;
- Të dallojë shenjat e afshit në lopë;
- Të shpjegojë metodën rektocervikale dhe përparësitë e saj në inseminimin artificial në lopë;
- Të shpjegojë metodën e inseminimit artificial në dele;
- Të shpjegojë dokumentacionin përkatës të inseminimit artificial në lopë;
- Të përshkruajë përparësitë e inseminimit artificial në dosa, pela dhe shpendë;
- Të shpjegojë veçoritë kryesore të aparatit gjinor të shpendët;
- Të shpjegojë metodën e marrjes, filtrimit, vlerësimit të spermës në harça, hamshorë, desh, cjep dhe gjela;
- Të listojë llojet e preparateve për nxitjen dhe sinkronizimin e afshit në kafshë;
- Të shpjegojë mënyrën e inokulimit të spermës në dosa, pela dhe shpendë;

### **Ushqimet dhe të ushqyerit**

- Të shpjegojë rëndësinë ekonomike të derrit, gjedhit, dhenve, shpendëve;
- Të klasifikojë ushqimet sipas prejardhjes (originës), vlerës energjitike dhe përmbajtjes së lëndës së thatë;
- Të shpjegojë përbërjen kimike të ushqimeve dhe koeficientin e tretshmërisë;
- Të rendisë ushqimet bazë në të ushqyerit e kafshëve sipas llojit dhe grup moshave;
- Të shpjegojë teknologjinë e përgatitjes së silazhit dhe senazhit;
- Të shpjegojë teknologjinë e përgatitjes dhe ruajtjes së ushqimeve të thata (barë, sanë,

kashtë) dhe të koncentruara;

- Të shpjegojë përgatitjen e qumështit nga soja, tërshëra dhe zëvendësuesve të tjerë të qumështit;
- Të dallojë ushqimet e kontaminuara nga myqet, ushqimet e kalbura, lëndët e huaja si dhe cilësitë organoleptike të tyre;
- Të shpjegojë nevojat ushqimore për mirëmbajtje, prodhim dhe riprodhim në kafshë dhe shpendë;
- Të shpjegojë strukturën e një racioni ushqimor të balancuar në energji, proteinë dhe lëndë minerale;
- Të shpjegojë mënyrën e përlllogaritjes të një racioni ushqimor të balancuar në energji, proteinë dhe lëndë minerale sipas nevojave fiziologjike të kafshës;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të një racioni bazë ushqimor për gjedhin, të imtat, derrat dhe shpendët;
- Të shpjegojë nevojat për energji, proteina, lëndë minerale dhe vitamina në kafshët për mish si: gjedh, derra, dhen, dhi, shpendë etj.;
- Të shpjegojë nevojat specifike të të ushqyerit të lopëve barse, në tharje, para pjelljes dhe në laktacion;
- Të shpjegojë të ushqyerit e viçave, gicave, qengjave dhe kecape sipas grupmoshës;
- Të listojë ushqimet dhe kushtet e dhënies së ushqimit gjatë çrregullimeve tek të porsalindurit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së të ushqyerit në gjendje patologjike në kafshë;
- Të shpjegojë përlllogaritjen e lopëve foragjere, të prodhimit të qumështit dhe përqindjes së yndyrës;
- Të shpjegojë teknologjinë e mbarështimit në shpendë;
- Të shpjegojë nevojat për lëndë minerale dhe vitamina në shpendët për mish dhe vezë;
- Të shpjegojë eksteriorin dhe konstitucionin në gjedhë, derra, dhen, dhi dhe shpendë;
- 

### **Kirurgjia profilaktike**

- Të shpjegojë rëndësinë e procesit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve;
- Të listojë teknikat e matrikullimit të kafshëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kastrimit dhe nevojën për të;
- Të listojë instrumentet e kastrimit;
- Të shpjegojë metodat e kastrimit në lloje të ndryshme të kafshëve;
- Të rendisë komplikacionet pas kastrimit;
- Të përshkruajë faktorët që ndikojnë mbi formën dhe cilësitë e thundrës;
- Të listojë mjetet që nevojiten për trajtimin e thundrave;
- Të hartojë një grafik mbi pastrimin dhe mirëmbajtjen e thundrave;
- Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e trajtimit të thundrës
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e prerjes së brirëve, bishtit, dhëmbëve dhe sqepit;

### **Procedura të thjeshta kirurgjikale**

- Të përkufizojë objektin e kirurgjisë veterinare;
- Të klasifikojë llojet e operacionit sipas qëllimit;
- Të rendisë mjetet dhe instrumentet kirurgjikale sipas funksionit të tyre;

- Të rendisë materialet kirurgjikale dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë metodat antiseptike, aseptike;
- Të shpjegojë mënyrat e sterilizimit të mjeteve dhe instrumenteve kirurgjikale;
- Të përshkruajë metodat e fiksimit të kafshëve të ndryshme;
- Të përshkruajë rëndësinë e përgatitjes së mjekut veteriner dhe kafshës para, gjatë dhe pas operacionit;
- Të rendisë mënyrat e injektimit të barnave;
- Të përshkruajë lëndët anestetike (lokale dhe të përgjithshme);
- Të përshkruajë elementet e operacionit kirurgjikal;
- Të klasifikojë llojet e lëndimeve (plagëve) dhe shkaqet e tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e mjekimit të plagëve;
- Të rendisë llojet e gjakderdhjeve dhe metodat e ndalimit të tyre;
- Të përshkruajë teknikat e fashimit;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe llojet e drenazhit;
- Të përshkruajë parimet dhe rregullat e qepjes së plagëve;
- Të përshkruajë llojet dhe specifikat e infeksionit kirurgjikal;
- Të shpjegojë mënyrat e mjekimit të infeksioneve kirurgjikale; (absese, fistula, flegmona, empiema etj.);
- Të shpjegojë metodat për ndërhyrje emergjente dhe mjetet përkatëse

### **Farmakologjia veterinare**

- Të përkufizojë objektin e studimit të farmakologjisë;
- Të përshkruajë mënyrat e futjes së barnave dhe veprimet e tyre në organizëm;
- Të listojë efektet anësore të barnave në organizëm nga përdorimi i përsëritur i tyre;
- Të përkufizojë recetën mjekësore dhe elementët përbërës të saj;
- Të listojë njësitë matëse farmakologjike;
- Të përshkruajë trajtat e ndryshme farmaceutike (ngurta, buta, lëngëta);
- Të përshkruajë veprimin e lëndëve farmaceutike në sipërfaqet mukoze dhe lëkurë;
- Të përshkruajë substancat farmaceutike rrudhëse, djegëse, zbutëse, oreks ndjellëse, purgative, vjellës etj.;
- Të përshkruajë veprimin e substancave në sistemin nervor, tretjes, kardiovaskular, frymëmarrjes dhe urogjinor;
- Të listojë substancat antimikrobike më të përdorshme në praktikën veterinare;
- Të përshkruajë veprimin e preparateve vitaminike e hormonale;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe afatin e përdorimit të preparateve mjekësore;
- Të përshkruajë rëndësinë e kohës së pezullimit të PMV<sup>3</sup> në produkte blegtorale;

### **Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor**

- Të shpjegojë arsyet e kampionimit të materialeve të ndryshme biologjike për analiza;
- Të listojë mjetet që nevojiten për kampionimin e materialeve për analizë;
- Të përshkruajë kushtet që duhet të plotësohen për mbledhjen e gjakut për analiza të ndryshme;

<sup>3</sup> **Preparateve Mjekësore Veterinare**

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë, Web site [www.akafp.gov.al](http://www.akafp.gov.al)

Tel/fax.+355 42237087

- Të përshkruajë kushtet që duhet të plotësohen për mbledhjen e urinës dhe feceve për analiza të ndryshme;
- Të listojë elementët e gjakut që kanë vlerë diagnostike;
- Të përshkruajë mënyrën e kryerjes së shtrirjes vaginale në qen e mace;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjeve të krusteve të lëkurës për vlerësim laboratorik;
- Të përshkruajë teknikën e marrjes së gjakut në gjedhë, derra, dele, shpendë etj.;
- Të tregojë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të qumështit në kafshë;
- Të përshkruajë mënyrën e marrjes së kampioneve nga organet e brendshme për në laborator në raste të therjeve të sforcuara;
- Të tregojë mënyrën e përdorimit të tamponit për marrjen e kampionit në kafshë;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të vezëve, të mjaltit dhe dyllit në koshere;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të peshkut në basenet e akuakulturës;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe transportit të kampionit të marrë;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të ushqimit për kafshë;
- Të përshkruajë mënyrat e marrjes, paketimit e dërgimit të materialeve patologjike në laborator;
- Të përshkruajë procedurat standard të marrjes së mostrave për sëmundje infektive;

#### **Kontrolli i kafshëve dhe produkteve blegtorale**

- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të kafshëve përpara therjes dhe mënyrat e transportit të tyre;
- Të klasifikojë kafshët sipas gjendjes së majmërisë;
- Të rendisë standardet për thertoret dhe mënyrat e therjes së kafshëve;
- Të përshkruajë kontrollin veterinar të mishit për sëmundje infektive dhe parazitare;
- Të përkufizojë termin “mish” dhe rrezen e mishit;
- Të rendisin elementet përbërës dhe faktorët që ndikojnë në përbërjen e mishit;
- Të përshkruajë cilësitë sipas klasifikimit të mishit në kafshë;
- Të përshkruajë mënyrat e konservimit të mishit dhe produkteve të tij;
- Të dallojë defektet e konservimit të mishit dhe të sallameve;
- Të tregojë përbërjen e qumështit dhe rëndësinë e kontrollit të tij;
- Të rendisë karakteristikat organoleptike të produkteve me origjinë shtazore;
- Të tregojë rëndësinë e kontrollit të produkteve me origjinë shtazore;
- Të përshkruajë zbatimin e ligjit të shërbimit veterinar për kontrollin e produkteve blegtorale;
- Të shpjegojë pikat kritike në proceset e përgatitjes së produkteve blegtorale;
- Të shpjegojë rregullat e HACCP4, si një standard ndërkombëtar i sigurisë së produkteve ushqimore;
- Të përshkruajë përpunimin e sigurt të mbetjeve organike në mjedise të veçanta të fermës;

<sup>4</sup>[Hazard Analyses and Critical Control Point](#)

### **Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të përshkruajë masat dhe rregullat për garantimin e sigurisë së jetës në punë;
- Të përshkruajë masat dhe rregullat për garantimin e mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm në fushën e shërbimit veterinarë;
- Të listojë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive dhe përdorimet e tyre gjatë punës;
- Të shpjegojë rëndësinë përdorimit të manualeve të pajisjeve dhe instrumenteve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë punës, si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të shpjegojë rregullat për dhënien e ndihmës së parë;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të interpretojë sinjalistikën e sigurisë së shëndetit në punë;
- Të analizojë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve veterinarë dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të përshkruajë rregullat dhe procedurat përkatëse të asgjësimit të mbetjeve veterinarë;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së mbeturinave sipas llojit;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes pastër të mjedisit të punës;

### **Komunikimi etik dhe profesional**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të Kodit të etikës;
- Të përshkruajë teknikat e punës në grup;
- Të listojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK5 në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;

### **Sipermarrje dhe edukim karriere**

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet kryesore financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare...);
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti të thjeshtë (duke identifikuar burimet e

<sup>5</sup> Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

- nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ilustron metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
  - Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe nevojat për kualifikime të mëtejshme;
  - Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetëvlerësimin.
  - Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
  - Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore;
  - Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
  - Të shpjegojë rëndësinë e marketingut në biznes;
  - Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;

### **Rezultatet e të nxënit në:**

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Veterinari” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi do të zotërojë shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të zbatojë kuadrin ligjor në fushën e Shërbimit Veterinar;
- Të menaxhojë burimet njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të përdorë mjetet, instrumentet dhe pajisjet në shërbimin veterinar;
- Të hartojë një preventiv për një shërbim të dhënë;
- Të respektojë hapat dhe afatet e realizimit të një shërbimi;
- Të përdorë dokumentacionin teknik në fushën e Shërbimit Veterinar;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të kryejë pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
- Të kontrollojë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës;

### **Higjiena**

- Të kontrollojë situatën shëndetësore të kafshëve në stalla;
- Të kontrollojë gjendjen teknike të sistemeve dhe pajisjeve të ndryshme blegtorale;
- Të kryejë pastrimin e lëkurës së trupit dhe gjirit të kafshëve;
- Të kryejë shërbime higjienike dhe klimatike të thjeshta në stallë;
- Të kontrollojë kushtet higjienike të ujit, të enëve të tij, baseneve, ujë pirëseve, si dhe procedurat e pastrimit të tyre;
- Të kontrollojë higjienën e impianteve mjelës, të impianteve të ushqimit dhe ujit në kafshë dhe shpendë;
- Të përdorë detergjent, dezinfektantë dhe pastrues të mbetjeve, në enët, makinat mjelëse apo

- sipërfaqe të tjera;
- Të kontrollojë mjediset dhe strehimet e kafshëve;
- Të kontrollojë kushte higjienike në vendqëndrime, vendpushime dhe ambiente të tjera;
- Të zbatojë kushtet higjienike për kafshët para, gjatë dhe pas pjelljes;
- Të kontrollojë zbatimin e masave higjienike gjatë mjeljes, ruajtjes, transportit dhe përpunimit të qumështit;
- Të dokumentojë dezinfektimin kimik dhe termik të stallave dhe territoreve të fermës;
- Të kontrollojë dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe mjedisit;
- Të kryejë procesin e qethjes në dhen

### **Sëmundjet infektive dhe profilaksia**

- Të dallojë ndryshimet makroskopike në kafshë për sëmundjet kryesore infektive;
- Të kryejë mjekimin me skemat përkatëse në kafshë me sëmundje kryesore infektive, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kryejë mjekimin sipas skemës përkatëse në kafshë me sëmundje kryesore infektive, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të zbatojë planin profilaktik për sëmundjet infektive në kafshë;
- Të zbatojë kalendarin vjetor të vaksinimeve në kafshë;
- Të kryejë vaksinimin e kafshëve bujqësore, kafshëve të shoqërimit dhe të shpendëve për sëmundje infektive;
- Të monitorojë reaksionet potenciale në kafshët e vaksinuara dhe të japë ndihmën e parë mjekësore veterinarë;
- Të zbatojë planin e masave profilaktike në fazën e dyshimit të një sëmundje infektive e më pas në fazën e konfirmimit;
- Të zbatojë rregullat e gjurmimit për sëmundjet infektive, sipas hapave përkatëse;
- Të mbajë dokumentacionin veterinar për sëmundjet infektive në kafshë të ndryshme;
- Të zbatojë rregullat dhe protokollet e miratuara në stacionet e karantinës veterinarë në nivel ekonomie, rajonal, shtetëror e më gjerë;
- Të zbatojë rregullat e izolimit të kafshëve në nivel ferme;
- Të zbatojë procedurën e larjes së duarve sipas rregullave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë gjatë manipulimit me kafshë, sidomos atyre të prekura nga sëmundjet infektive, punës në laborator etj.;
- Të kryejë asgjësimin kafshëve të ngordhura, të plehut, mbetjeve dhe materialeve mjekësore tjera të infektuara, etj. sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të zbatojë masat veterinarë për mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zoonotike;
- Të zbatojë rregullat e biosigurisë në fermë për kontrollin e sëmundjeve infektive;
- Të kontrollojë zbatimin e përpiktë të rregullave të biosigurisë nga vizitorët;
- Të zbatojë parimet themelore për mirëqenien e kafshëve;
- Të kontribuojë në respektimin e pesë lirive themelore të kafshëve;
- Të zbatojë rregullat e dezinfektimit të mjeteve në portën e hyrjes së fermës;
- Të dokumentojë zbatimin e planit të dezinfektimeve;
- Të kryejë dezinfektimin kimik të stallave dhe territoreve të fermës për parandalimin e sëmundjeve infektive;
- Të përgatisë dezinfektantët kimikë sipas qëllimit të përdorimit të tyre;

- Të kontrollojë zbatimin e procedurës së përpunimit termik të plehut, veçanërisht në rastet e sëmundjeve infektive;
- Të dallojë shenjat klinike për sëmundjeve infektive dhe parazitare;

### **Ushqimet dhe të ushqyerit**

- Të kontrollojë cilësinë e ushqimeve me anë të prekjës, nuhatjes dhe ngjyrës;
- Të kryejë procese pune të përgatitjes me krahë të barit të thatë si ushqim për blegtorinë;
- Të transportojë ushqimet nga magazina në stallë me krah ose me mjete të thjeshta sipas llojit të ushqimit;
- Të përzgjedhë ushqimet sipas llojit të kafshës, drejtimit të prodhimit, kategorive, gjendjes fiziologjike e shëndetësore;
- Të zbatojë mënyrën e të ushqyerit të kafshëve sipas kategorive, gjendjes fiziologjike dhe shëndetësore, si dhe drejtimit ekonomik të tyre;
- Të realizojë kullotjen e lirë të kafshëve në kullota;
- Të asistojë në përgatitjen e përpunimit të ushqimeve: silazh, senazh, të thata, përgatitjen e koncentratës, të zëvendësuesve të qumështit;
- Të përgatisë racione ushqimore bazë të balancuara në energji, proteinë dhe lëndë minerale sipas llojit të kafshës, drejtimit të prodhimit dhe nevojave fiziologjike;
- Të përzgjedhë ushqimet dhe kushtet e dhënies së tyre gjatë çrregullimeve tek të porsalindurit;
- Të përzgjedhë ushqimet dhe kushtet e dhënies së tyre sipas gjendjes patologjike të kafshës;
- Të përllorarisë lopët foragjere, prodhimin e qumështit dhe sasinë e yndyrës;
- Të zbatojë teknologjinë e mbarështimit në shpendë;
- Të përllorarisë nevojat për lëndë minerale dhe vitamina në shpendët për mish dhe vezë;
- Të mbikëqyrë eksteriorin dhe konstitucionin në gjedhë, derra, dhen, dhi dhe shpendë;
- Të realizojë çeljen e zogjve në inkubator;
- Të realizojë përgatitjen e ushqimit artificial të bletëve sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kujdeset për mbarështimin dhe ushqyerjen e shpendëve dekorativë;
- Të kujdeset për rritjen, edukimin, ushtrimin dhe të ushqyerit e kafshëve të shoqërimit;

### **Anatomia dhe fiziologjia e kafshëve**

- Të përcaktojë rajonet kryesore anatomike të trupit sipas nomenklaturës bazë anatomike;
- Të përcaktojë topografinë e parastomakëve dhe organeve të tjera të sistemit të tretjes;
- Të përcaktojë rajonin e askultimit dhe perkutimit të zemrës dhe mushkërive.
- Të përcaktojë pozicionin e askultimit të peristaltikës së rumenit dhe zorrëve.
- Të gjejë pozicionin e venës jugulare, venës së bishtit dhe venës brachiale në qen dhe mace;

### **Trajtimi i kafshëve barse**

- Të zbulojë shenjat e afshit në kafshë të ndryshme me metodën e vrojtimit;
- Të dallojë shenjat gjatë ciklit seksual (afshit);
- Të zgjedhë mënyrat e ndërimit për kafshët që mbarështon;



- Të zbatojë masat higjienike në kafshët barse për organet gjinore dhe gjirin;
- Të kryejë kontrollin e jashtëm të mbarsmërisë nëpërmjet palpimit tek dhentë, dhitë dhe dosat;
- Të kontrollojë zhvillimin embrional dhe fetal;
- Të dallojë ndryshimet anatomike, fiziologjike në periudhën e mbarsmërisë në kafshë;
- Të dallojë shenjat paralajmëruese, procesin e pjelljes dhe fazat e tij;;
- Të dallojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme;

#### **Ndihma në pjelljet e vështira**

- Të dallojë shenjat klinike në pjelljet e vështira dhe fazën kur duhet të ndërhyje;
- Të kryejë përgatitjen e vendit, kafshës dhe të mjeteve/instrumenteve;
- Të kryejë rregullimin e pozicionit të frytit në pjelljet e vështira;
- Të ndihmojë kafshën gjatë aktit të pjelljes;

#### **Patologjitë e organeve të riprodhimit dhe trajtimi i tyre**

- Të dallojë shenjat e dhimbjeve të parakohshme në kafshët barsë;
- Të identifikojë dështimet në kafshë;
- Të dallojë shenjat klinike në pjelljet e vështira në kafshë;
- Të zbatojë metodat e ndërhyrjes pa gjak në pjelljet e vështira në kafshë;
- Të përdorë mjetet dhe instrumentet në pjelljet e vështira;
- Të dallojë shenjat për prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme;
- Të kryejë mjekimin për prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme;
- Të kryejë mjekimin dhe trajtimin e patologjive të organeve gjinore në kafshë të ndryshme;
- Të përgatisë tretësisë dezinfektuese për patologjitë e organeve gjinore.
- Të përgatisë kafshën për mjekimin e patologjive të organeve gjinore
- Të kryejë heqjen e shtratit me dorë;
- Të kontrollojë nxjerrjen e placentës të kafsha pas pjelljes;
- Të kryejë mjekimin për mbetje të shtratit në kafshë të ndryshme ;
- Të ndërhyjë me barna për heqjen e shtratit, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kryejë mjekimin e lopëve me prolaps të vagjinës, të mitrës dhe pezmatimit të saj (metrite), në mënyrë lokale dhe të përgjithshme, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të përcaktojë shkaqet e shterpësisë të përkohshme dhe të përhershme në kafshë sipas rastit;

#### **Trajtimi i kafshëve të porsalindura**

- Të kryejë lidhjen dhe dezinfektimin e kërthizës tek të porsalindurit;
- Të ndërhyjë tek të porsalindurit me asfiksi, ftohje trupore, hipoglicemi;
- Të zbatojë mënyrat e trajtimit dhe masat parandaluese në asfiksi, ftohje trupore dhe hipoglicemi në kafshët e porsalindura
- Të kryejë mjekimet tek të porsalindurin me patologji të ndryshme, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të komunikojë vazhdimisht me specialistin veterinar;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale;
- Të mbajë dokumentacionin veterinar;

### **Kirurgjia profilaktike**

- Të realizojë procesin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve sipas dokumentacioneve përkatës;
- Të kryejë matrikullimin e kafshëve me metoda të ndryshme;
- Të kryejë kastrimin me metoda të ndryshme në lloje të ndryshme të kafshëve;
- Të zbatojë grafikun për mirëmbajtjen e thundrave;
- Të përdorë mjete të thjeshta dhe elektroteknike, për prerjen e thundrave;
- Të përcaktojë vendet (pozicionet) e kryerjes së injeksioneve në kafshë të ndryshme;
- Të kryejë mjekimin e thundrave, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kryejë prerjen dhe kauterizimin e brirëve në gjedh;
- Të presë bishtin e kafshëve, me metoda të ndryshme, sipas llojit të tyre;
- Të kryejë prerjen e dhëmbëve canine në gica;
- Të presë sqepin në shpendë, me metoda të ndryshme;
- Të kryejë marrjen e gjakut (salaso) në kafshë, për qëllime diagnostikimi;
- Të mjekojë kafshët sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të dezinfektojë dhe sterilizojë mjetet dhe pajisjet kirurgjikale me mënyra të ndryshme;

### **Procedura të thjeshta kirurgjikale**

- Të kryejë fiksimin e kafshëve me metoda të ndryshme;
- Të përdorë mjetet dhe instrumentet kirurgjikale sipas funksionit të tyre;
- Të përgatitë kafshën para, gjatë dhe pas operacionit;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale para, gjatë dhe pas operacionit;
- Të përgatitë fushën e operacionit me metodat antiseptike, aseptike;
- Të kryejë injeksione në kafshë/shpendë me metodën intradermale, subkutane, intramuskulare dhe intravenoze;
- Të kryejë injeksionin e lëndëve anestetike (lokale dhe të përgjithshme);
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë mjekimit e trajtimit të plagëve kirurgjikale;
- Të kryejë tualetin e plagëve;
- Të kryejë mjekimin e plagëve të thjeshta kirurgjikale;
- Të kryejë mjekimin e plagëve të shkaktuara nga djegia dhe ngrirja
- Të kryejë mjekimin e absesit, fistulës, flegmonës, empiema etj.;
- Të kryejë drenazhimin e plagëve;
- Të realizojë prerjen dhe qepjen e indeve me teknika të ndryshme;
- Të ndalojë hemorragjinë me metoda të ndryshme;
- Të realizojë fashimin e plagëve sipas vend lokalizimit në rajonin e trupit;
- Të kryejë ndërhyrje emergjente duke përdorur mjetet përkatëse;

### **Farmakologjia veterinare**

- Të kryejë administrimin e barnave sipas veprimit të tyre në organizëm;
- Të kontrollojë kafshën për efektet anësore të barnave në organizëm nga përdorimi i përsëritur i tyre;
- Të zbatojë recetën mjekësore me elementët përbërës të saj;
- Të përcaktojë njësitë matëse farmakologjike sipas trajtave të tyre;

- Të përgatitë trajtat e ndryshme farmaceutike (ngurta, buta, lëngëta);
- Të kontrollojë veprimin e lëndëve farmaceutike në sipërfaqet mukoze dhe lëkurë;
- Të përdorë substancat farmaceutike rrudhëse, djegëse, zbutëse, oreks ndjellëse, purgative, vjellës etj., sipas udhëzimeve të mjekut veterinar;
- Të kontrollojë veprimin e substancave në sistemin nervor, tretjes, kardiovaskular, frymëmarrjes dhe urogjinor sipas udhëzimeve të mjekut veterinar;
- Të përdorë substancat antimikrobike më të përdorshme në praktikën veterinare sipas udhëzimeve të mjekut veterinar;
- Të përdorë preparate vitaminike e hormonale;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe afatin e përdorimit të preparateve mjekësore;
- Të zbatojë kohën pezullimit të PMV në produkte blegtorale;

### **Mjetet dhe instrumentet veterinare**

- Të përdorë veglat e thjeshta kirurgjikale, për ndërhyrje kirurgjikale të thjeshta, si për prerjen e indeve, ndalimin e hemoragjisë dhe qepjen e indeve të dëmtuara te kafshët;
- Të përdorë mjete dhe pajisje për fiksimin e kafshëve të ndryshme, si litar, javasha, stativ (konstrukcion metalik), etj.;
- Të përdorë pajisje dhe vegla pune për ekzaminimin e kafshës së sëmurë, si çekiç, plesimetër, fenendoskop/stetoskop, termometër, etj.;
- Të përdorë mjete dhe instrumente si sondë ezofagale dhe troakar (kanula) në patologjitë e aparatit tretës;
- Të përdorë mjete dhe instrumente që nevojiten për inseminimin artificial të kafshëve (kontejner, mikroshiringë, vaginoskop, etj.);
- Të realizojë ruajtjen e materialit biologjik në kontejner në kushte të përshtatshme;
- Të përdorë laktodensimetër për matjen e densitetit të qumështit;
- Të përdorë mjete të thjeshta si: litar. çengela të thjeshtë\ të përbërë, pinca të gjata kirurgjikale, fetotom të fshehtë, i gishtit, sharrë teli, etj., gjatë ndërhyrjes në pjellje të vështira;
- Të përdorë instrumente si sondë shigjetë në patologjinë e kanalit të thithave
- Të përdorë ovoskopin për kontrollin e vezëve;
- Të përdorë darët e thundrave dhe mjetet për pastrimin e prerjen e thundrave
- Të kryejë sterilizimin e instrumenteve\mjeteve kirurgjikalë me pajisje si sterilizator, aerosteril, bikser, autoklavë, etj.;
- Të përdorë mjete për kastrimin e kafshëve si darë burdizzo në dema, desh, cjep dhe emasculator në gica;
- Të përdorë mikroskopin për vrojtimin e strisheve mikroskopike;
- Të përdorë kimikate në trajtë tretësire për dezinfektimin e instrumenteve të inseminimit artificial të kafshëve;

### **Metodat e ekzaminimit të kafshëve**

- Të kryejë ekzaminimin e kafshëve të sëmura me anë të shikimit, palpimit, perkutimit dhe të auskultimit;
- Të kontrollojë konsistencën, temperaturën, ndjeshmërinë e zonës së sëmurë;
- Të kontrollojë qëndrimin e kafshës, ndryshimet e formës dhe madhësisë së barkut,

urinimin, jashtëqitjen, etj.;

- Të kontrollojë lëvizjet peristaltike të rumenit me fenendoskop/stetoskop;
- Të kryejë matjen e temperaturës, pulsit dhe frymëmarrjes me mjetet përkatëse;
- Të kryejë dëgjimin e punës së zembrës dhe mushkrive;

### **Trajtimi dhe profilaksia e patologjive të gjirit**

- Të dallojë shenjat klinike kryesore në mastitet e kafshëve;
- Të përcaktojë shkaqet dhe shenjat klinike të mastiteve në kafshë;
- Të kryejë kontrollin lokal të gjëndrës së gjirit për mastite;
- Të të dërgojë për analizë në laborator mostrën e qumështit për mastite;
- Të kontrollojë qumështin e mjelë për treguesit organoleptikë: ngjyra, konsistenca , shija, si dhe përzierjet (gjak, qelb, etj.);
- Të kryejë analiza të thjeshta të qumështit për mastite, duke përdorur indikatorë;
- Të kryejë mjekimin lokal dhe të përgjithshëm të kafshës me mastite klinike (antibiotikë, sulfamide, etj.) sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të zbatojë mjekimin dhe masat parandaluese të mastiteve në kafshë;
- Të zbatojë masat profilaktike për parandalimin e mastiteve në kafshë;
- Të përdorë tretësira dezinfektuese për gjirin, sipas porosisë së mjekut specialist;
- Të përcaktojë llojin e mastitit ne përputhje me kohëzgjatjen dhe karakterit të inflamacionit sipas rastit;
- Të diferencojë mastitet klinike nga mastitet subklinike (të fshehta) në lopë;
- Të dallojë plagët e gjirit sipas shenjave klinike

### **Kontrulli dhe mjekimi i sëmundjeve organike**

- Të dallojë shenjat klinike kryesore në kafshë me sëmundjeve të aparatit tretës, të aparatit të frymëmarrjes, të sistemit urinar, etj.;
- Të kontrollojë kafshët me sëmundjeve të aparatit tretës, të aparatit të frymëmarrjes, të sistemit urinar, etj.;
- Të mjekojë kafshët me sëmundje të aparatit tretës, të aparatit të frymëmarrjes në kushtet e mbarështimit të kafshëve në fermat blegtorale, sipas porosive të mjekut veteriner;
- Të kryejë mjekime në kafshët ripërtypëse me timpani akute sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kryejë funksionin e rumenit duke përdorur troakar (kanula);
- Të kontrollojë lopët me atoni të parastomakëve;
- Të kryejë mjekimin medikamentoz me ruminator sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kontrollojë dhe mjekojë kafshët e reja me gastroenterit, bronkopneumoni, etj. sipas porosive të mjekut veteriner;
- Të kryejë mjekimin medikamentoz në kafshët e shoqërimit, derra dhe shpendë sipas udhëzimeve të specialistit;

### **Siguria ushqimore**

- Të zbatojë masat shëndetësore veterinarë për produktet me origjinë shtazore, të prodhuara në fermë;
- Të kryejë kontrollin makroskopik të mishit të gjedhit, mishit të shpendëve;

- Të kryejë vlerësimin organoleptik të qumështit, peshkut dhe vezëve;
- Të kontrollojë shijen, erën, ngjyrën dhe konsistencën e qumështit, sipas standardit të kërkuar;
- Të identifikojë kafshët nën mjekim me substanca që lënë mbetje në produkte me origjinë shtazore;
- Të evidentojë kafshët që mjekohen me barna të cilat mbeten në produktet me origjinë shtazore
- Të kryejë ndarjen anatomike të mishit sipas standardit;
- Të kryejë matjen e densitetit të qumështit sipas rregullave me laktodensimetër;
- Të kontrollojë freskinë e vezëve me anë të ovoskopit: gjendjen e freskisë, madhësinë e dhomës së ajrit;

### **Masat veterinare për mbrojtjen e shëndetit publik**

- Të sigurojë asgjësimin e sigurt të kafshëve të ngordhura, kadavrave, konfiskateve, mbeturinave të kafshëve dhe produkteve të kafshëve, jo për konsum njerëzor.
- Të zbatojë masat e profilaksisë të përgjithshme dhe specifike nga sëmundjet të transmetueshme nga kafshët;
- Të realizojë largimin, përpunimin dhe asgjësimin e sigurt të mbetjeve në fermë;
- Të zbatojë masat shëndetësore veterinare për lëndët e papërpunuara, kullotat, ujin dhe vendet e pirjes së ujit për kafshët.

### **Mjekimi dhe dehelmintizimi i kafshëve**

- Të dallojë ndryshimet makroskopike të organeve të infestuara;
- Të kryejë analiza të thjeshta helmintologjike, për gjetjen e helmintëve në fekale;
- Të kryejë mjekimin dhe dehelmintizimin e gjedhit, të imtave, derrave, qenve dhe maceve me sëmundje helmintoze;
- Të përgatisë “emulsionin bazë” për mjekimin dhe dehelmintizimin e të imtave, për sëmundjen e Zgjebes ;
- Të kryejë banjëzim të imtave në vaskë banjëzimi ;
- Të kryejë dhënie të preparatit antiparazitar kafshës, sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kryejë mjekimin e kafshëve dhe shpendëve me preparate me pluhurosje, tretësira anti-ektoparazitare, si dhe me preparate në rrugë parenterale;

### **Përmirësimi racor në kafshë**

- Të zbatojë programin racor kombëtar në përputhje me zonat ku operojnë.
- Të dallojë racat kryesore të kafshëve sipas drejtimit ekonomik;
- Të përzgjedhë saktë damazin për çiftëzim mbështetur në kartelën gjenealogjike;
- Të përlllogarisë pjellorinë në lopë;

### **Inseminimi artificial i kafshëve**

- Të kryejë mënyrat e shumëzimit në shpendë;
- Të kontrollojë çeljen e zogjve në inkubator;
- Të kryejë rritjen dhe shumimin e krimbit të mëndafshit dhe bletës;
- Të dallojë pjekurinë seksuale dhe atë trupore të kafshëve;

- Të kontrollojë ciklin seksual sipas periudhave dhe karakteristikave të tij në lloje të ndryshme kafshësh.
- Të dallojë format e trupit të verdhë;
- Të përzgjedhë hormonet në rregullimin e ciklit seksual sipas rolit të tyre;
- Të kryejë sinkronizimin e afshit;
- Të dallojë reflekset seksuale
- Të kontrollojë ndërzimin në kafshë
- Të kryejë kontroll mbasmerie;
- Të kryejë larjen dhe sterilizimin e instrumenteve për inseminimin artificial të kafshëve;
- Të kontrollojë kontanierin për sasinë e azotit të lëngët;
- Të përgatisë shtrirje mikroskopike nga sperma;
- Të kryejë vlerësimin mikroskopik të spermës për gjallërinë dhe dendësinë e spermatozoideve;
- Të kryejë vlerësimin e jashtëm të spermës si: vëllimi, ngjyra, aroma, dendësia;
- Të kryejë fiksimin e qafës së mitrës në lopë, nëpërmjet metodës rektocervikale;
- Të përgatisë mikrosiringën për inokulimin e spermës;
- Të kryejë inokulimin e spermës në lopë me metodën rektocervikale;
- Të kryejë inokulimin e spermës në dosa dhe të imta me vaginoskop;

#### **Detyrat e teknikut të inseminimit artificial**

- Të përdorë material biologjik vetëm nga ato subjekte të cilat operojnë sipas rregullores;
- Të kryejë kontrollin e mbarsmërisë në lopë;
- Të plotësojë me saktësi regjistrin e ndërzim–pjelljes;
- Të njoftojë pronarin e kafshës për datën e inseminimit fekondues;
- Të ruajë dokumentacionin për 5 vjet duke e bërë atë të disponueshëm;
- Të mbajë dokumentacionin për inseminimin artificial të lopëve;

#### **Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor**

- Të shpjegojë arsyet e kampionimit të materialeve të ndryshme biologjike për analiza;
- Të listojë mjetet që nevojiten për kampionimin e materialeve për analizë;
- Të përshkruajë kushtet që duhet të plotësohen për mbledhjen e gjakut për analiza të ndryshme;
- Të përshkruajë kushtet që duhet të plotësohen për mbledhjen e urinës dhe feceve për analiza të ndryshme;
- Të listojë elementët e gjakut që kanë vlerë diagnostike;
- Të përshkruajë mënyrën e kryerjes së shtrirjes vaginale në qen e mace;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjeve të krusteve të lëkurës për vlerësim laboratorik;
- Të përshkruajë teknikën e marrjes së gjakut në gjedhë, derra, dele, shpendë etj.;
- Të tregojë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të qumështit në kafshë;
- Të përshkruajë mënyrën e marrjes së kampioneve nga organet e brendshme për në laborator në raste të therjeve të sforcuara;
- Të tregojë mënyrën e përdorimit të tamponit për marrjen e kampionit në kafshë;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të vezëve, të mjaltit dhe dyllit në koshere;

- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të peshkut në basenet e akuakulturës;
- Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe transportit të kampionit të marrë;
- Të përshkruajë mënyrën e mbledhjes së kampioneve të ushqimit për kafshë;
- Të përshkruajë mënyrat e marrjes, paketimit e dërgimit të materialeve patologjike në laborator;
- Të përshkruajë procedurat standard të marrjes së mostrave për sëmundje infektive;

#### **Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor**

- Të përdorë mostra të materialeve të ndryshme biologjike për analiza;
- Të përzgjedhë mjetet për marrjen e mostrave për analizë;
- Të zbatojë kushtet për marrjen e mostrës së gjakut për analiza të ndryshme;
- Të zbatojë kushtet për marrjen e mostrës së urinës dhe feceve për analiza të ndryshme;
- Të evidentojë elementët e gjakut që kanë vlerë diagnostike;
- Të kryejë shtrirje vaginale në qen e mace;
- Të mbledhë kruste të lëkurës për vlerësim laboratorik;
- Të zbatojë teknikën e marrjes së gjakut në gjedhë, derra, dele, shpendë etj.;
- Të marrë mostrat e qumështit në kafshë;
- Të kryejë marrjen e mostrave nga organet e brendshme për në laborator në raste të therjeve të sforcuara;
- Të përdorë tamponin për marrjen e mostrave në kafshë;
- Të marrë mostrat e vezëve, të mjaltit dhe dyllit në koshere;
- Të marrë mostrat e peshkut në basenet e akuakulturës;
- Të zbatojë kushtet e ruajtjes dhe transportit të mostrave të marra;
- Të marrë mostrat e ushqimit për kafshë;
- Të kryejë marrjen, paketimin dhe dërgimin e materialeve patologjike për laborator;
- Të zbatojë procedurat standarde të marrjes së mostrave për sëmundje infektive;

#### **Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të respektojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
- Të përdorë pajisjet e mbrojtjes personale sipas rregullores;
- Të zbatojë procedurat e trajnimit dhe të informimit në fushën e veterinarisë, për pronarët apo kujdestarët e fermave të kafshëve dhe publikun.
- Të mbrojë kafshët duke siguruar mirëqenien e tyre;
- Të mbrojë kafshët e egra në mjediset e zooparkut;
- Të kontrollojë trajtimin higjienik të jashtëqitjeve dhe mbeturinave të lëngshme;
- Të asgjësojë mbetjet mjekësore veterinarë sipas legjislacionit përkatës;
- Të zbatojë legjislacionin veterinar për parandalimin e sëmundjeve që transmetohen nga kafshët tek njeriu;
- Të zbatojë rregullat për garantimin e sigurisë së jetës në punë;
- Të zbatojë rregullat për garantimin e mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë legjislacionin dhe dokumentacionin e detyrueshëm në fushën e shërbimit veterinar;
- Të përdorë pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive gjatë punës;
- Të përdorë manualet e pajisjeve dhe instrumenteve të punës;

- Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti në punë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe evakuimit në raste zjarri, tërmeti, fatkeqësi natyrore etj.;
- Të zbatojë sinjalistikën e sigurisë së shëndetit në punë;
- Të zbatojë rregullat dhe procedurat përkatëse të asgjësimit të mbetjeve veterinare;
- Të ndajë mbeturinat sipas llojit të tyre;

### **Komunikimi etik dhe profesional**

- Të përdorë Kodin e etikës;
- Të përdorë teknikat përkatëse komunikimin me kolegë dhe klientë;
- Të zbatojë teknikat e punës në grup;
- Të zbatojë teknikat e duhura për zgjidhjen së mosmarrëveshjeve;
- Të përdorë mendimin kritik;
- Të përdorë TIK6 në komunikim;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;

### **Sipërmarrje dhe edukim karriere**

- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;
- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse;
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problem në mënyrë krijuese në kontekste të ndryshme;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në përshtatje me nevojat e tregut të punës;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të përdorë mjetet e nevojshme të informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi mbikëqyrëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burimet e duhura duke bashkëpunuar me institucionet financiare dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;

<sup>6</sup> Teknologji Informacioni dhe Komunikimi



- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës.
- Të hartojë një plan efektiv biznesi në fushën e prodhimeve blegtorale për krijimin e një biznesi të ri (ose për modifikim, shtesë, rinovimi, të një biznesi ekzistues), për njësi të vogla prodhimi, për linja apo reparte prodhimi, duke u bazuar në procedura standarde;
- Të kryejë detyra tekniko-menaxheriale, në mbikëqyrje e specialistëve, për realizimin e një plan biznesi, sipas planeve e programeve të hartuara nga menaxherët e nivelit me të lartë ose të një stafi menaxherial;
- Të hartojë dokumente të thjeshta financiare;
- Të kryejë marketingut e biznesit;

## **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

### **Individi duhet të jetë i aftë:**

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.